

Reginald McNeil

Drejtori i Përgjithshëm

July 8, 2021

Të dashur prindër dhe familje të Distriktit Arsimor të Filadelfias,

Kjo letër synon t'ju informojë mbi të rejat e Shërbimeve të Transportit për fëmijën tuaj gjatë vitit të ardhshëm shkollor. Nga kjo vjeshtë, nxënësit e Distriktit Arsimor të Filadelfias të cilët përdorin Sistemin e Transportit të Pensilvanisë Juglindore (SEPTA) për transportim në shkollë do të marrin Abone të reja falas për Nxënësit, në vend të Transpass. Nxënësit që i plotësojnë kriteret do t'i marrin abonete të tyre kur të paraqiten personalisht për ditën e parë të shkollës dhe duhet t'i përdorin ato për të shkuar dhe kthyer nga shkolla gjatë vitit shkollor. Aboneja për Transportin e Nxënësve do të funksionojë për sa kohë nxënësi vazhdon t'i plotësojë kushtet dhe të jetë i regjistruar në shkollë. **Nxënësit që udhëtojnë do të mundën të udhëtojnë me SEPTA-n falas të martën në 31 gusht, 2021 - ditën e parë të shkollës.**

Aboneja SEPTA për transportin e nxënësve është një kartë pa kontakt, me çip dhe shumë-përdorimshe, të cilën nxënësit mund ta "cakisin" deri në tetë herë në ditë gjatë ditëve të shkollës, nga ora 5:30 e mëngjesit e deri në 8:00 të mbrëmjes në çdo autobus, trolejbus ose metro. Nëse nxënësi preferon të përdorë linjën rajonale të trenave (Regional Rail) ata mund t'i shtojnë vlerë abonesë së nxënësve në stacionet e caktuara të SEPTA-s për rreth \$10 në çdo 5 ditë shkollore në javë.

Shëndeti dhe mirëqenia e nxënësve tanë vazhdon të jetë prioriteti ynë kryesor dhe SPD së bashku me SEPTA-n punojnë pa u lodhur për t'i mbajtur sa më të sigurt gjatë ditëve të shkollës. SEPTA i ka rritur masat e sigurisë duke vendosur më shumë roje në linjën Market-Frankford, linja më e frekuentuar e SEPTA-s, dhe më e përdorur nga nxënësit për të shkuar në shkollë. Drejtoria e transportit gjithashtu ka filluar pastrimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve përgjatë linjave hekurudhore të Market-Frankford dhe Broad Street. Punonjësit do të punojnë gjatë natës për të pastruar mirë stacionet dhe mjetet e udhëtimit, si edhe për të kryer rregullime e mirëmbajtje si rregullimin e ashensorëve, lyerjen e mureve, larjen me ujë me forcë, dhe instalimin e dritave dhe tabelave të reja. Të gjitha mjetet e udhëtimit janë të ajrosura shumë mirë, me anë të kombinimit të sistemeve HVAC dhe hapjet e mbylljet e shpeshta të dyerve për hipjet e zbritjet e udhëtarëve. SEPTA vazhdon të ndjekë rregullat e CDC-së dhe TSA-së për sa u përket maskave dhe masave të tjera të sigurisë për COVID-19 në transportin publik.

Me anë të programit falas të Qytetit të Filadelfias [Safe Routes Philly](#), nxënësit dhe familjet e tyre mund të shohin planet mësimore, ushtrimet dhe burimet në anglisht dhe spanjisht mbi sigurinë në transportin publik, dhe të pajisen me diturinë dhe aftësitë e nevojshme për të udhëtuar në mënyrë të sigurt tek dhe nga shkolla. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të distriktit [SEPTA Student Fare Card webpage](#).

Ju mirëpresim ju dhe fëmijët tuaj në vjeshtë!

Sinqerisht,



THE SCHOOL DISTRICT OF  
PHILADELPHIA

**OFFICE OF OPERATIONS**

440 North Broad Street  
Philadelphia, PA 19130

**Reginald McNeil**

Drejtori i Përgjithshëm

Reggie McNeil  
Drejtori i Përgjithshëm